VENDIM
Nr. 148, datë 4.10.2019

MBI REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË OST SHA, PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË "RREGULLAT E PËRKOHSHME TË MEKANIZMIT BALANCUES", MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 193, DATË 24.11.2017

Në mbështetje të nenit 16, të nenit 98 dhe të nenit 100, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 15 dhe të nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 4.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 92/6, datë 30.10.2019, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., për miratimin e disa shtesave në "Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 26/1, datë 14.1.2019, ka kërkuar rishikimin e "Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, duke propozuar:

Në nenin 12, pika 2, pas germës "c" të shtohet germa "d", me këtë përmbajtje:

Të dispeçuar për të reduktuar prodhimin e energjisë elektrike ose për të rritur konsumin si shërbim balancimi do të paguajë me çmimin e llogaritur si HUPX DAM, çmim të një ore specifike të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo mwh të disbalancës.

Në nenin 12, pika 3, pas germës "c" të shtohet germa "d", me këtë përmbajtje:

Të dispeçuar për të rritur prodhimin e energjisë elektrike ose të reduktojë konsumin si shërbim balancimi do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM, çmim të një ore specifike të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWH të disbalancës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 19, datë 18.2.2019, filloi procedurat për miratimin e disa shtesave në "Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE -s", miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, ERE, me shkresën 32/6 prot., datë 18.2.2019, publikoi në medien e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure, nga ku rezultoi se nuk u paraqit asnjë opinion ose sugjerim nga palët e interesit, në lidhje me këto shtesa.

- ERE, në zbatim të nenit 15, pika 3 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", me shkresën nr. 177 prot., datë 21.2.2019, përcolli për marrje mendimi në lidhje me vendimin e bordit nr. 19, datë 18.2.2019, pranë palëve të interesit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë OSHEE sh.a. Në përfundim të afatit 15-ditor, vetëm shoqëria KESH sh.a. ka shprehur mosdakordësinë e saj në lidhje me këto shtesa, për aq kohë sa mungojnë analizat e shkaqeve që motivojnë kërkesën për ndryshim.

- Po ashtu, me shkresën nr. 178 prot., datë 21.2.2019, ERE i kërkoi OST sh.a. kryerjen e simulimeve dhe argumentimet përkatëse që vlerësojnë sjelljen me propozimet e reja, si dhe konsultimet e propozimeve me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, si bashkëpërpilues të këtyre rregullave, sipas parashikimeve, gjithashtu, të pikës 2 të vendimit të mësipërm.

- Nga ana e saj shoqëria OST sh.a., nëpërmjet shkresë me nr. 26/4 prot., datë 28.3.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/1 prot., datë 29.3.2019, informon se ka përcjellë pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për mendim, shtesat e propozuara së bashku me simulimet përkatëse.

- ERE, me shkresën nr. 178/2 prot., datë 5.4.2019, ka kërkuar prej shoqërisë OST sh.a., të përcjellë pa vonesë pranë ERE-s dhe palëve të interesit, simulimet, sikurse kërkohet në pikën 2 të vendimit të bordit nr. 9, datë 18.2.2019.

- Në përgjigje të shkresës sipërcituar, OST sh.a., nëpërmjet të sajës nr. 26/6 prot., datë 16.4.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/3, datë 17.4.2019, ka bërë me dije ERE-n dhe KESH sh.a., në lidhje me simulimet e kryera, të cilat faktojnë se ndryshimet e kërkuara prej saj janë të argumentuara.

- Më tej, në përgjigje të shkresës së përcjellë nga ana e OST sh.a., me shkresën nr. 178/4 prot., datë 8.5.2019, kemi kërkuar prej shoqërisë OST sh.a., që të depozitojë pranë ERE-s simulimet me të dhëna të detajuara faktike të përllogaritjes së disbalancave, për periudhat përkatëse në të cilat pretendohet se mekanizmi balancues në fuqi, nuk ka adresuar në mënyrë konkrete kostot dhe të dhënat me ndryshimet e koeficienteve, siç propozohet nga OST sh.a., pasi simulimet e paraqitura rezultonin të përgjithshme dhe nuk evidentonin saktë problematikën e pretenduar në kërkesën e OST sh.a.

- OST sh.a., me shkresën nr. 26/9 prot., datë 17.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/5, datë 20.5.2019, ka përcjellë përllogaritjen e disbalancave vetëm për muajin shkurt 2019, e cila nuk rezulton të jetë e detajuar dhe e argumentuar sa duhet, si dhe kopje të korrespondencës së dërguar për konsultim te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 26/10 prot., datë 21.5.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/6, datë 23.5.2019, shoqëria i është drejtuar ERE-s dhe KESH sh.a., për të sqaruar se, duke qenë në cilësinë e operatorit të sistemit, është përgjegjëse për të ndërmarrë masat e nevojshme për të balancuar sistemin fizikisht dhe të administrojë procesin e llogarive financiare, por në asnjë rast OST sh.a., nuk synon një rezultat financiar në favor të portofolit të vet, pasi ky portofol duhet të jetë neutral, por aplikimi i koeficientëve aktualë ka krijuar humbje në portofolin e llogarive të disbalancave. Nisur nga ky fakt theksojnë, se kostot financiare nuk janë derivat të mënyrës se si menaxhohet sistemi i transmetimit, por janë derivat të balancimit në kohë reale të sistemit të transmetimit dhe se është detyrim i saj balancimi kundrejt sistemeve fqinje. Po ashtu, OST sh.a. nuk synon ndarjen e kostove të balancimit me ofruesin e shërbimit të balancimit dhe se mekanizmi balancues në fuqi synon të penalizojë nëpërmjet disbalancave të gjithë pjesëmarrësit që operojnë në treg, për disbalancat që këta të fundit krijojnë.

- ERE, nëpërmjet shkresës me nr. 178/7 prot., datë 3.7.2019, duke pasur parasysh rëndësinë që kanë këto rregulla i ka kërkuar OST sh.a., qëndrimin përfundimtar të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për shtesat e propozuara në "Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues", me qëllim mostejkalimin e afateve të përcaktuara në ligj për t'i dhënë fund praktikës së nisur nëpërmjet vendimit të bordit të datës 18.2.2019.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria OST sh.a., me shkresën me nr. 4477/2 prot., datë 25.7.2019, protokolluar në ERE me nr. 178/9, datë 29.7.2019, ka bërë me dije, se është akoma duke bërë simulime në lidhje me impaktin që do të japin ndryshimet e kërkuara në "Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues" dhe, aktualisht, po analizon dhe po monitoron sjelljet e pjesëmarrësve të tregut konform mekanizmit balancues në fuqi, si dhe kërkon të vazhdojë vlerësimin dhe për një periudhë tjetër njëmujore, periudhë e cila ka përfunduar në datën 29.8.2019.

- ERE, me vendimin e bordit nr. 118, datë 22.7.2019, ka filluar, gjithashtu, procedurën për miratimin e "Rregullave përfundimtare të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike". Me miratimin dhe me hyrjen në fuqi të këtyre rregullave do të shfuqizohen të gjitha aktet e tjera me të

cilat, aktualisht, rregullohet mekanizmi balancues i tregut të energjisë elektrike, përfshirë dhe rregullat tranzitore.

- Në përfundim të afateve, si dhe pas korrespondencave të shumta mes ERE-s dhe OST sh.a, si dhe për gjithë sa sipërcituar, konstatojmë që:

- Nuk ka një qëndrim të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me shtesat dhe ndryshimet e propozuara nga ana e OST sh.a. në "Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues", siç kërkohet në pikën 2, të vendimit nr. 19, datë. 18.2.2019, të bordit të ERE-s.

- Duke qenë vetë OST sh.a., e cila me konsulencën përkatëse të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ka propozuar këto rregulla për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, pjesë përbërëse të të cilave ishin dhe koeficientët përkatës, gjatë procesit të përpilimit dhe të miratimit, nuk ka pasur pretendime nga asnjë nga palët lidhur me to, përfshire këtu OST sh.a.

- Rregullat ekzistuese përfshirë dhe koeficientët e vendosur kanë pasur si qëllim neutralitetin financiar të OST sh.a. dhe, si të tilla, nuk mund të krijojnë kosto financiare për operatorin e sistemit.

- OST sh.a., deri më sot, nuk argumentoi dhe as dokumentoi me kalkulime, se në ç'mase zbatimi i koeficientëve që përcaktohen aktualisht në mekanizmin e përkohshëm të balancimit, jep efekte negative për shoqërinë dhe as se ndryshimet e propozuara do të shmangin në të ardhmen këto efekte të prezumuara.

- Për më tepër që, vetë OST shprehet në shkresën e datës 25.7.2019, se, citojmë: "është akoma duke bërë simulime në lidhje me impaktin që do të japin ndryshimet e kërkuara në "Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues" dhe, aktualisht, po analizon dhe po monitoron sjelljet e pjesëmarrësve të tregut", si rrjedhojë përcjellja e propozimit për ndryshimin e rregullave ka qenë pa bërë simulimet e duhura.

- Duke qenë se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë që nga adresimi i kërkesës për shqyrtimin e propozimeve, nëpërmjet vendimmarrjes së ERE-s për fillimin e procedurës së shqyrtimit të këtyre propozimeve dhe me gjithë kërkesën e vetë OST sh.a., për një periudhë njëmujore dhe kjo periudhë u tejkalua nga këta të fundit.

- Duke qenë se pas marrjes së propozimit të OST sh.a. për miratimin e rregullave të mekanizmit të balancimit të tregut të energjisë elektrike, bordi i ERE-s ka filluar tashmë procedurën për shqyrtimin dhe për miratimin e këtij akti rregullator definitiv i cili mund dhe duhet të adresojë çdo problematikë të konstatuar pas hyrjes në fuqi të ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe të modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për miratimin e disa shtesave në "Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë OST sh.a. dhe palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti